PLANI OPERACIONAL

I ZHVILLIMIT VENDOR

BASHKIA DELVINË

SWEDEN

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Embassy of Switzerland in Albania

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI PËR ÇËSHTJET VENDORE

Cooperazione Italiana allo Sviluppo
Ministero Affari Esteri
Cooperazione Internazionale

USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

Mars, 2016

Përgatitur nga:
Shoqata MISIONARËT E TË DREJTAVE SOCIALE

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje 5

1. Plani operacional afatshkurtër në perspektivën e qeverisjes lokale dhe proceseve planifikuese 7

2. Metodologjia për përgatitjen e POZHL 9

3. Diagnoza 11

3.1 Fakte kryesore 11

3.2 Zhvillimi ekonomik 12

3.3 Mirëqenia ekonomike dhe sociale 15

3.4 Infrastruktura dhe shërbimet bazë 16

3.5 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore 18

3.7 *Historia* 18

3.6 Konkluzione 20

4. Përcaktimi i problemeve dhe prioriteteve operacionale afat-shkurtra duke përfshirë pemën e problemeve 22

5. Plani Operacional i Zhvillimi Lokal 28

HYRJE

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore në bashkëpunim me STAR (Support to Territorial and Administrative Reform) Shqipëri asiston bashkitë e reja shqiptare në hartimin e Planeve Operacionale të Zhvillimit Lokal. Reforma Administrativo-Territoriale është një nga reformat më të mëdha që ka ndërmarrë qeveria e cila pati një impakt të gjerë tek qeverisja vendore, ku nga 373 Njesi vendore u krijuan 61 bashki të reja.

Plani Operacional i Zhvillimit Lokal (POZHL) është një Plan 3 vjeçar afatmesën i cili rishikohet çdo vit në varësi të burimeve financiare që bashkia Delvinë ka në dispozicion dhe ka si qëllim identifikimin dhe prioritarizimin e investimeve që bashkia angazhohet të realizojë këtë periudhë. Për çdo investim të parashikuar si prioritet i qytetarëve dhe bashkisë është përcaktuar qartë periudha e realizimit të investimit, burimi i financimit, kostoja e investimit, mënyra e investimit dhe të dhëna të tjera.

Duke e konsideruar POZHL si një instrument kyç të menaxhimit të vet financiar, Bashkia ka bërë të mundur identifikimin e nevojave dhe mundësive në lidhje me investimet kapitale. Njëkohësisht, metodologjia e përshkruar në këtë dokument përbën "standardet" ku do të duhet të ecim në të ardhmen. Ajo përcakton qartë dhe saktë rrugën të cilën ne do të duhet të ndjekim në vitet që vijnë. Në të njëjtjën kohë, POZHL, duke shërbyer si një instrument i rëndësishëm i menaxhimit financiar, siguron dhe jep një tabllo të qartë të nevojave dhe mundësive të Bashkisë.

Për sa më sipër, duke qenë se stafi i Bashkisë po aplikon për herë të parë këtë mënyrë planifikimi të investimeve kapitale, është e nevojshme të rendisim edhe disa avantazhe kryesore të cilat kanë si qellim:

- Orienton vëmendjen në qëllimet, nevojat dhe mundësitë financiare të Bashkisë
- Siguron një sensibilizim publik në shkallë të gjerë mbi nevojat për hartimin e një plani efektiv investimesh
- Përmirëson bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet stafit të Bashkisë të përfshirë në proçesin e hartimit të tij
- Ndihmon Bashkinë të shmangë gabimet në llogaritjen e kostove të projekteve në infrastrukturë dhe e bën atë më të besueshme për qytetarët
- Ndihmon Bashkinë në rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe mirëmenaxhimin e burimeve financiare

POZHL do të shërbejë si një instrument kyç në punën e bashkisë së re Delvinë ku të gjitha planifikimet për investime do të bazohen tek ky plan i cili do të jetë i lidhur ngushtë me të ardhurat vjetore të bashkisë dhe planifikimin e buxhetit vjetor të saj.

Bashkia Delvinë, pas rishikimit vit pas viti të këtij proçesi, synon që, mbas 3 vjetësh, të ketë përmbushur të gjithë ato objektiva të përcaktuara së bashku, realizimi i të cilave do të thotë:

- nivel më të lartë mirëqenieje për komunitetin
- lagje (blloqe banimi) të zhvilluara në brendësi, duke i kushtuar një rëndësi më të madhe ndërhyrjeve për krijimin e mjediseve të gjelbëruara, mjediseve për çlodhje dhe argëtim
- jetë kulturore më të pasur dhe aktive
- shërbime publike të siguruara për të gjithë territorin dhe komunitetin
- infrastrukturë fizike të kënaqshme jo vetëm në qendër por edhe në periferi
- menaxhim i mirë dhe efektiv i territorit
- zona informale të legalizuara
- nivel i ulët dhe parandalimin e ndotjes

1. Plani operacional afatshkurtër në perspektivën e qeverisjes lokale dhe proceseve planifikuese

Ajo çka pritet nga ky proçes planifikimi është hartimi i një metodologjie të saktë dhe të qartë të planifikimit të investimeve kapitale në vite, e cila do të na shërbejë për përcaktimin e prioriteteve, mënyrën e shpërndarjes së investimeve, kostot e ndërtimit, mbulimin e këtyre kostove etj. Në fund të ketij proçesi, ne së bashku do të arrijmë të përmbushim ato prioritete të cilat vetë komuniteti ka identifikuar, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës gjë e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do të bëjë të mundur edhe përmirësimin e mënyrës së jetesës.

Kryetari i Bashkisë duhet të ndërtojë një staf që i përgjigjet nevojave të komunitetit të tij dhe më e rëndesishme të mund të realizojë ato premtime që i ka bërë këtij komuniteti.

Duke qënë se Bashki Delvinë nuk ka një Plan Strategjik të Zhvillimit Lokal ishte e domosdoshme hartimi i Planit Operacional të Zhvillimit Lokal.

Ashtu si edhe çdo objektiv tjetër i Bashkisë, proçesi i hartimit, rishikimit të POZHL kërkon jo vetëm hartimin, miratimin dhe zbatimin e një kalendari aktivitetesh por edhe monitorimin e tij. Me qëllim hartimin, miratimin dhe zbatimin e tij, mbështetur edhe në metodologjinë e hartimit të POZHL, u bë e mundur hartimi i kalendarit të aktiviteteve konkrete mbi bazën e të cilave shtrihet ky proçes. Në këtë kalendar janë të identifikuar

- aktivitetet
- afatet
- personat përgjegjës etj.

Hartimi i këtij kalendari është i domosdoshëm pasi nëpërmjet zbatimit të tij do të mund të identifikjmë ku jemi me POZHL, ku duam të shkojmë, si do të shkojmë, çfarë duhet të bëjmë por, ndërkohë e bën POZHL të matshëm, pra na jep mundësinë të monitorojmë proçesin. Kalendari i aktiviteteve të Bashkisë sonë për hartimin e POZHL është si më poshtë:

21 Shtator – Tetor 2015

Në muajin Tetor me Urdhër të Brendshëm të Kryetarit të Bashkisë u ngrit Grupi i Punës

për hartimin e POZHL i cili, mbështetur në metodologjinë e hartuar si dhe mbi bazën e kërkesave të rajoneve, zyrës së informacionit por edhe vetë qytetarëve përcaktoi politikat kapitale të vitit të cilat më pas udhëhoqën proçesin e POZHL. Po kështu, grupi i punës i POZHL bëri të mundur:

Parashikimin e fondeve në dispozicion për projekte kapitale

Identifikimin/analizimin e burimeve të financimit të investimeve

Fillimin e punës në lidhje me POZHL

Shpërndarjen e udhëzimeve/formularëve për kërkesat e projekteve kapitale në departamentet, drejtoritë e Bashkisë dhe ndërmarrjeve në varësi të saj

Nentor 2015

Në këtë periudhë, grupi i punës së POZHL ka ndjekur këto hapa si më poshtë:

U bë vlerësimi i realizimit të planit të aktiviteteve të miratuara për periudhën 3 mujore

U bë e mundur shqyrtimi paraprak i projekteve të paraqitura

Filloi puna për grumbullimin e materialeve, njohjen e situatës dhe vlerësimin e saj

Kryetari i Bashkisë dhe stafi i POZHL organizuan takime e anketa me komunitetin mbi POZHL e propozuar si dhe aprovuan draftin e POZHL si një dokument të planifikimit të investimeve.

Dhjetor 2015

Në këtë periudhë materiali i përgatitur do të paraqitet për diskutim e miratim në Këshillin Bashkiak. Mbas miratimit të materialit nga Këshilli Bashkiak, Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë do të nënshkruajnë Buxhetin dhe POZHL për vitet në vazhdim.

Më sipër, në këtë material, ne paraqitëm të gjitha mundësitë dhe mjetet për realizimin e POZHL në Bashki për vitet 2016 – 2019, duke bërë të mundur orientimin e vizionit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit tonë. Kjo mënyrë e planifikimit të Investimeve do të drejtojë Bashkinë dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proçes, në vitet që pasojnë, në rrugën e duhur në përmbushjen e prioriteteve të qytetit tonë. Ky dokument, i cili vjen për herë të parë para Jush, u hartua pas një pune të gjatë dhe intensive të stafit të Bashkisë të asistuar prej Organizatës MDSK me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe projektit STAR.

2. Metodologjia për përgatitjen e POZHL

Duke qënë se POZHL është një dokument me karakater planifikimin e investimeve kapitale te bashkisë së re, ky proces kërkon ngritjen e një grupi pune për hartimin e tij. Hartimi i tij kërkon kohe burime njerëzore dhe takime me grupe të ndryshme interesi nga komuniteti i bashkisë Delvinë.

Ngritja e grupit të punës për Hartimin e POZHL – ekspertët e organizatës MDSK realizuan disa takime me kryetarin e bashkisë dhe stafin e tij dhe u ngrit grupi i punës:

1. Ilir Mehmeti - Nenkryetari i Bashkise Delvinë
2. Dritan Xhaferi-Nenkryetar i Bashkise Delvine
3. Marsida Demaj - Pergjegjese Zyra e Planifikimit dhe Kontrollit te zhvillimit te Territorit (Zyra e Urbanistikes)
4. Fejzo Ali - Drejtor i Tatim Taksave Delvine
5. Eleni Jorgji - Drejtore e Financave
6. Anila Janku - Pergjegjese e Zyres se Ndihmes Ekonomike
7. Elisaveta Cama - Drejtore e Personelit dhe Burimeve Njerezore

Grupi i Punës, i ngritur për këtë qëllim, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e organizatës MDSK bëri të mundur :

a. Hartimin dhe zhvillimin e metodologjisë së POZHL

b. Përcaktoi politikat që do të ndiqen për zbatimin e POZHL

c. Përcaktoi metodat e financimit të projekteve të Planit të Investimeve Kapitale

d. Analiza Financiare e burimeve të POZHL

e. Identifikimi i projekteve që do të futen në POZHL dhe përgatitjen e kërkesave që duhet të plotësojë një projekt për tu klasifikuar si Investim Kapital

f. Rishikimi i kërkesave për përzgjedhjen dhe prioritarizimin e projekteve

g. Pregatitja e modelit të paraqitjes dhe aprovimit nga Këshilli Bashkiak.

Fazat ku ka kaluar proçesi

POZHL ka qënë një proces i cili është hartuar nëpërmjet pjesëmarrjes dhe kontributit të palëve të interesuara, duke e bërë komunitetin pjesë të proçesit. Si i tillë, POZHL i Bashkisë sonë, vjen jo vetëm si një produkt i vlefshëm në duart e administratës dhe qytetarëve por si një proçes ku janë përfshirë të gjithë aktorët e duhur të mundshëm, aktorë të cilët do të përfshihen edhe në proçesin e monitorimit të tij. Në vijim të kësaj tradite të qëndrueshme komunikimi të vazhdueshëm me komunitetin, tani e më tej, ky proçes do të jetë një nga shtyllat kryesore të buxhetit me pjesëmarrje që Bashkia jonë organizon çdo vit.

Hartimi dhe zhvillimi i metodologjisë së POZHL

Ky proçes është mbështetur në metodologjinë e hartimit dhe zbatimit të POZHL metodologji kjo e hartuar dhe e miratuar tashmë nga Grupi i Punës dhe departamentet përkatëse.

Aplikimi i kësaj mënyre të re planifikimi investimesh kapitale bën të mundur që Bashkia të përpiqet vazhdimisht të gjenerojë sa më shumë burime financiare në kohë dhe jo vetëm kaq por ato të jenë të mjaftueshme dhe të sigurta, mbështetur në nevojat dhe objektivat e parashikuara në POZHL.

Për hartimin dhe zbatimin e POZHL Bashkia Delvinë është mbështetur në disa kritere specifike të cilat fillimisht janë diskutuar dhe pranuar nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proçes.

Të hartojë politikat dhe kriteret që do të udhëheqin përgatitjen në çdo vit të POZHL dhe buxhetin vjetor kapital. Këto politika janë konsultuar dhe do të vazhdojnë të konsultohen jo vetëm me Departamentet dhe Drejtoritë e Bashkisë por dhe me ndërmarrjet në varësi të saj, të cilat përgatisin kërkesat e tyre për investime kapitale, siç mund të jenë arsimi (sistemi parashkollor), shërbimet publike, mirëmbajtje rrugë trotuare, ujësjellës etj.

3. Diagnoza

3.1. Fakte kryesore



Bashkia e re e Delvinës kufizohet në veri me bashkitë Himarë e Gjirokastër, në jug me bashkitë Sarandë dhe Finiq, ndërsa në lindje me bashkinë Dropull. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Delvinës.

Kjo bashki përbëhet nga 2 njësi administrative, të cilat janë: Delvinë dhe Vergo. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Delvinës dhe qarkut Vlorë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 17 fshatra.

Bashkia e re përbëhet nga qyteti historik i Delvinës dhe komuna Vergo, pjesë e rrethit Delvinë. Qyteti i Delvinës ka kultivuar një histori të pasur të bashkëjetesës fetare mes myslimanëve, kristianëve dhe hebrenjve në të shkuarën. Qyteti ka traditë në artizanat si dhe objekte të trashëgimisë kulturore, të cilat nuk përdoren aktualisht për turizëm.

Bashkia Delvine laget nga Lumi i Delvines 22.3 km i gjate. Kjo bashki është e pasur me perrenj te cilet zene nje siperfaqe prej 77.8 m2 brenda qytetit. Nder Liqenet permendim ate te Rusanit i cili eshte disi i demtuar dhe ze nje siperfaqe 3.2 ha dhe ka nje kapacitet prej 200 000 m3. Persa i perket ndertimeve ne qytet dominojne kryesisht ndertimet e vjetra te cilat jane te vendosura kryesisht ne lagjen "Lejla Malo" si dhe shtëpitë karakteristike delvinjote të vendosura pranë qendrës së qytetit. Ndërtimet e reja në qytet jane kryesisht banesa private 2-3 kate dhe ato me pak te ndertuarat jane banesat 5-6 kate.

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia e re numëron 7,598 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil kjo bashki ka një popullsi prej 18,078 personash. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 182.9 km2. Densiteti i popullsisë sipas censusit është 45.5 banorë/ km2, ndërsa sipas regjistrit civil është 99 banorë/ km2.

Dinamika e Popullsisë

Bashkia Delvinë ka një popullsi prej 7.598 banorësh sipas të dhënave të Census-it të vitit 2011 dhe është e përbërë nga 2 njësi ekzistuese (1 komunë dhe 1 bashki). Kjo zonë ka ulje të popullsisë prej pothuaj 13% (fig.1). Dendësia mesatare në zonën funksionale është 41 banorë për km², në krahasim me 107 dhe 14 banorë për km² që është dendësia e popullsisë, përkatësisht në njësitë ekzistuese të Delvinës dhe Vergos.

Bashkia Delvinë ka nje popullsi dominuese që i përket minoritetit grek, rom dhe egjyptian. Janë të shumta familjet e kësaj bashkie që migrojnë drejt Sarandës dhe Tiranës pasi kanë më shumë mundësi punësimi. Persa i perket emigrimit jane te shumta familjet qe punojne dhe jetojne ne emigracion kryesisht ne shtetin Grek dhe ate Italian. Statistikat e fundit tregojne se numri i familjeve te ardhura nga emigracioni eshte shtuar. Mesatarisht kthehen ne vit per te jetuar ketu 2-3 familje. Numri mesatar i lindjeve eshte 13 lindje ne muaj.



Fig.1

Profili ekonomik i bashkisë

Ekonomia e bashkisë Delvinë është një ekonomi mikse, me natyrë bujqësore dhe të shërbimit. Qyteti i Delvinës është një qytet me potencial të lartë zhvillimi duke u bazuar në pozitën gjeografike në të cilën ndodhet. Njësia Administrative Vergo ka një ekonomi kryesisht bujqësore.

3.2 Zhvillimi ekonomik

Në qytetin e Delvinës rezulton që popullsia është e punësuar rreth 39% në shërbime, në sektorin e ndërtimit 19% dhe në sektorin e tregëtisë 18%. Pjesa e banorëve të cilët janë punësuar në bujqësi arrin në 30% kurse pjesa tjetër janë të punësuar në sektorë të tjerë.(fig.2)

Njësitë administrative	Profili ekonomik	Detaje
Delvina	Njësi vendore mikse malore	Bujqësia midis 52-63%; Sipërfaqja e pjerrët > 36%
Vergo	Njësi vendore bujqësore mikse malore	Bujqësia midis 70-80%; Sipërfaqja e pjerrët >52%

Fig.2

3.2.1 Bujqësia dhe blegtoria

Pozita gjeografike e favorshme ka ndikuar mjaft në mbjelljen dhe kultivimin e drurëve frutore dhe agrumeve në këtë zonë.

Bujqësia, blegtoria dhe vreshtaria, krahas institucioneve publike janë burimet kryesore ekonomike të zonës. Papunësia është shumë e lartë dhe një pjesë e madhe e popullsisë punon në Sarandë.

Bashkia Delvinë, e cila ka në përbërjen e vet qytetin e Delvinës dhe fshatrat Sopot (Varfaj), Kakodhiq, Lefterohor, Rusan, Vllahat, Bamatat, Stjar dhe Vane, shtrihet në një sipërfaqje prej 5 387 hektarësh dhe Njësia Administrative Vergo me përbërjes e fshatrave Tazat, Kalasë, Fushë Verri, Senicë, Kopacez, Qafë Dardhë, Bajkaj shtrihet në një sipërfaqe prej 129 km2 në terren kodrinor i cili ka favorizuar zhvillimin e bujqësisë dhe të frutikulturës.

Një pjesë e mirë e banorëve merren me kultivimin dhe vjeljen e ullirit, rrushit, qershisë, gështenjave, bajameve, arrave etj. si dhe me kultivimin e perimeve të ndryshme të cilat tregëtohen në tregjet brenda dhe jashtë Bashkisë Delvinë. Në njësinë administrative Vergo vihet re nje ekonomi bujqësore e cila është e vetmja mundësi për banorët e saj.

Bashkia Delvinë ka kushte klimatiko – tokësore shumë të përshtatshme për kultivimin e të gjitha llojeve të kulturave bujqësore (vreshta, pemishte, ullishte, agrume, kultura agrare etj.) si dhe shtimin e një sërë kategorish të kafshëve bujqësore që kanë të bëjnë me nevojat direkte të popullsisë si dhe të turistëve kryesisht në periudhën e verës. Produktet rurale dhe artizanati janë pjesë e rëndësishme e sektorit agroushqimor dhe përmirësimi i këtyre burimeve është i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të zones së Njësisë Administrative Vergo. Mjedisi eshtë shumë i përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë në luginat dhe fushëgropën e Delvinës Tharja e kënetave në fushëgropën e Delvinës dhe bonifikimi i tyre, sistemimi i shtretërve të lumenjve edhe në luginat e tjera, si dhe sigurimi i ujitjes artificiale, të kryera në dhjetëvjetëshat e gjysmës së dytë të shek. XX, rriten pjellorinë e tokave. Klima e ngrohtë, është shumë e përshtatshme për shumë lloje frutash dhe kultura të tjera të drunjta. Fushëgropa e Delvinës dhe shpatet e kodrave përreth janë të përmendura për prodhimin e ullinjve dhe të agrumeve, të cilat këtu gjejnë kushtet më të përshtatshme klimatike për zhvillimin e tyre. Në fushëgropën e Delvinës është i përhapur rrushi e fiku.

Një karakteristikë tjetër në këtë fushë është pasuria rajonale e bimëve medicinale, të cilat janë të shumëllojshme. Megjithatë mbetet problem mbledhja jashtë kritereve e këtyre bimëve me vlerë natyrore dhe mjekësore.

3.2.2 Industria

Industria në zonën e bashkisë Delvinë punëson një përqindje të konsiderueshme të banorëve të saj. Kryesisht pjesa e qendrës së Bashkisë ka të zhvilluar një zonë biznesi e cila

ka rreth 150 subjekte fizike dhe juridike në njësi tregëtare prodhimi dhe përpunimi që janë biznese familjare.

Bashkia e Delvinës ka qenë një qytet i zhvilluar industrial i cili kishte një aktivitet të rëndësishëm si në shkallë qarku por dhe në nivel kombëtar duke pasur disa fabrika si ajo e miellit, e vajit, e recelit, përpunimit të domates, Ndërmarrjen e përpunimit artizanal, veshmbathje, tapiceri dhe rrobaqepsi kryesisht veshje ushtarake. Sot disa familje të kësaj bashkie kanë krijuar bizneset e tyre familjare duke ruajtur traditën me një prodhim shumë të vogël vjetor.

3.2.3 Turizmi

Delvina ka një reliev të larmishëm, hidrografi të pasur, kushte të favorshme klimaterike. Fshatrat e kësaj zone ruajnë disa tipare të dallueshëm nga vendbanimet e tjera, që përmbajnë mjaft potenciale natyrore, historike e kulturore me vlera për zhvillimin e turizmit rural. Banorët janë njohës të traditave të lashtësisë, sidomos për mbarështimin e blegtorisë, frutikulturën dhe kultivimin e perimeve, tradita këto të bazuara nga prania e përhershme e ujrave të Kalasës dhe Bistricës. Fushëgropa e Delvinës është e formuar nga një fundosje e madhe tektonike, që vazhdon të ulet, prandaj fushat e saj janë të rrafshëta. Pjesa më e madhe e tyre ishte e kenetezuar nga vërshimet e shpeshta ne vitet '70 te Shekullit XX. Ne kete fushegrope ngrihen si ishuj kodra te uleta. Ne lindje ajo rrethohet nga vargje malore. Klima eshte tipike mesdhetare, me dimer te bute dhe te lagesht e vere te nxehte dhe shume te thate.

Nuk është e lehtë të përshkruash një vend si Delvina dhe as koha nuk do të mjaftonte. Mund të konsiderohet një qytet tepër i vogël por i qetë, ku gjithsecili gjen vetveten duke gëzuar harmoni mes miqsh. Qytetarët e Delvinës i karakterizon një kulturë, traditë dhe zakon i trashëguar dhe respektuar brez pas brezi. Mikëpritja, zemërgjerësia, dashuria dhe besa janë virtytet me të larta të cilat banorët i ruajnë edhe sot. Rakia dhe vera, dy pijet e preferuara të banorëve jane të pranishme në çdo tryezë familjare dhe miqësore. Këto kanë pasur një vlerë të veçantë në të shkuarën.

Këngët dhe vallet janë ushqim shpirtëror për qytetarët. E duke folur për muzikën, kujt delvinjoti nuk do ti shkonte mendja tek "Sazet e Delvinës", grupi polifornik "Djemtë e Delvinës" dhe tek "Zërat e Rinj". Sazet ishin grupi i "artistëve" të cilët kompozonin dhe luanin muzikë popullore tradicionale shqiptare. Banda e tyre ishte e përbërë nga njerëz të talentuar që i binin me shumë mjeshtëri veglave muzikore. Drejtuesi dhe këngëtari i talentuar Myrteza Leka ishte një nga figurat më të dashura për qytetarët. Sazet i jepnin një ngjyrim të veçantë jetës së qytetit. Ato ishin të pranishme në çdo dasëm delvinjote, në çdo festë, organizim, dhe aktivitet. Banda e saj shkonin të ftuar në dasma edhe jashtë qytetit duke martuar me qindra çifte. Ato vazhdojnë të jenë edhe sot, me po kaq rëndësi për jetën e këtij qyteti. Në këtë drejtim, këtij qyteti edhe pse vitet rrokulliseshin dhe brezat ndërroheshin, gjithçka pothuajse i mbetej e njëjtë. Delvina ka nxjerrë nga gjiri i saj personalitete, artistë të cilët i kanë dhuruar Shqipërisë vlera. Emra si Sulejman Delvina, Namik Delvina (patriotë të shquar), Hajrie Veizi (Rondo) aktorë e talentuar, Irini Qiriako këngetare etj, janë nderi e krenaria e qytetit. Artistja e merituar, Hajrie Rondo e ka ngjitur qytetin e Sulejman e Namik Delvinës në majën e malit Sopot.

3.3 Mirëqenia ekonomike dhe sociale

Bashkia e Delvinës ka një potencial të madh të zhvillimit ekonomik dhe një rritje të mirëqenies ekonomike dhe sociale të saj.

Sipas të dhënave të Bashkisë Delvinë numri i bizneseve gjithsej është 251, nga të cilët 229 janë të vendosur në qytetin e Delvinës dhe 22 në Njesinë Administrative Vergo.

Numri i bizneseve është ulur në vitin 2015. Bizneset për 1000 banorë luhaten nga 12 Vergo, në 40 në Delvinë.

Njësia		Nr. i bizneseve	Biznese për 1000 banorë
Delvinë	Bashkia	229	40
Vergo	Njesia Administrative	22	12
Totali		251	52



Delvina në vitin 2015 kishte një buxhet (të ardhurat e veta) prej rreth 16 milion lekësh. Nga këto, rreth 43% ose 75 milion janë realizuar në bashkinë e Delvinës, e cila realizon edhe 50% të të ardhurave të veta.

Bashkia Delvinë shpenzon mesatarisht 35% të buxhetit për shpenzime administrative. Pesha e investimeve është mjaft e ulët në këtë bashki e cila ka bërë disa investime modeste

Punësimi

Struktura moshore e popullsisë karakterizohet nga tregues të ulët të forcës aktive të punës dhe të moshës së re. Ndërsa, treguesi i moshës së tretë i lartë. Këto tregues flasin për plakje të popullsisë, dhe shpjegohet me fenomenin e emigrimit të popullisë në drejtim të Greqisë dhe italisë. Ky fenomen ka prekur shumë rininë dhe forcën më aktive të punësimi. Këto tregues të ulët të forcës aktive ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik, sidomos të sektorit të bujqësisë.

Në qytetin e Delvinës shkalla e papunësisë është 13 % dhe paraqitet më e ulët dhe është poshtë mesatares se papunësisë për vendin tonë. Ngjashëm paraqitet edhe indeksi i

papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjeç), 35% dhe për femrat 28%. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë lokale, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë:

Punësimi në Bashkinë e Delvinës karakterizohet nga tregues të ulët të forcës aktive pune dhe të moshës së re. Emigracioni drejt shtetit grek dhe italian është tregues pse në bashkinë e Delvinës ka një plakje të popullsisë gjithashtu dhe të rinjtë që studiojnë në qytete të tjera si Tirana nuk kthehen për të punuar në qytetin e lindjes.

Në krahasim më bashkitë e tjera shkalla e papunësisë në territorin e bashkisë Delvinë është e ulët dhe është poshtë mesatares së papunësisë në shkallë vendi. Indeksi i papunësisë për bashkinë është 15 % ku mesatarja për vendin e këtij treguesi është 29.3 %. Indeksi i të punësuarëve është 85 % nga të cilët 50% janë vetëpunësuar dhe pjesa tjetër punojnë në administratën shtetërore. Banorët që punojnë në territorin e Bashkisë Delvinë janë në masën 85 %, pjesa tjetër e banorëve janë të papunë. 50 % e tyre janë të vetëpunësuar dhe pjesa tjetër punojnë në administratën shteterore. Papunësia zë 15 % të popullsisë e përkthyer në numër kjo vlerë arrin numrin 551 të papunë nga të cilët 282 janë femra dhe 269 janë meshkuj.

3.4 Infrastruktura dhe shërbimet bazë

3.4.1 Infrastruktura e shërbimeve bazë:

arsimi, shëndetësia, aktivitetet sociale dhe sportive

Në Bashkinë e Delvinës duke parë treguesit arsimorë, vihet re një diferencë midis qytetit dhe njësë administrative Vergo, sidomos për sa i përket numrit të fëmijëve për mësues në shkollat 9 vjeçare. Ndërkohë që në qytet numri i fëmijëve është 17 në atë të Vergos është 38, gjë që tregon presionin e madh për sistemin arsimor për një shpërndarje dhe menaxhim më të mirë. Për sa i përket sistemit parashkollor në qytet e fshat raportohen përreth 7-16 fëmijë për edukatorë. Nga pikëpamja e nivelit arsimor që lidhet dhe me ofertën në tregun e punës, kemi mbizotërim të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm e fare pak të diplomuarve nga arsimi lartë. Banorët e kualifikuar prefererojnë të jetojnë në qytetin ku kanë kryer studimet si Tiranë, Vlorë etj dhe nuk dëshirojnë të kthehen në Delvinë.

Delvina ka një spital, i cili u shërben dhe zonës përreth, ndërkohë që shpërndarja e mjekëve për familje (MPF) dhe mjekë specialist (MS) sipas qendrave shëndetësore, është në bashkinë Delvinë 4, dhe në Njësinë Administrative Vergo 1 mjek.

Për sa i përket shërbimeve sociale, në bashkinë Delvinë, nuk ndodhet asnjë qendër shërbimesh sociale. Qytetet më të afërta nga të cilat mund të përfitohen shërbime sociale, janë Saranda dhe Gjirokastra, por që dhe këto njësi, sigurisht që nuk ofrojnë tërë kategoritë bazë të shërbimeve.

Koha e udhëtimit drejt qendrës së bashkisë Delvinë, është 33 minuta, nga Komuna Vergo, pra qendra arrihet në më pak se një orë, çka lehtëson ndërveprimin e qytetarëve me institucionet e qeverisjes vendore dhe aksesin në shërbime. Infrastruktura rrugore nuk është e zhvilluar shumë mirë në komunën Vergo.

3.4.2 Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore e bashkisë Delvinë karakterizohet nga një rrjet rrugor i amortizuar dhe mungesa e investimeve vihet re që në rrugën kombëtare për të shkruar në Delvinë.

Problematike shfaqet edhe rrjeti rrugor që lidh Bashkinë Delvinë më Njësinë Administrative Vergo që e cila sjell dhe probleme në ofrimin e shërbimeve publike për të gjithë tërritorin e saj dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë banorët. Infrastruktura rrugore nëpërmjet Qendrës së Bashkive dhe fshatrave në përbërje të saj është tejet e amortizuar dhe sjell shqetësime në lëvizjen e lirë të banorëve. Madje, në zonën kodrinore-malore të bashkisë aksesi pothuajse bëhet i pamundur.

Përmirësimi i infrastrukturës lidhëse rurale do të rrisë kohezionin social të komunitetit në bashki dhe nga ana tjetër do të rrisë aksesin në shërbimet bazë. Infrastruktura e dobët rrugore ka ndikuar negativisht edhe në frekuentimin e shkollës nga nxënësit e fshtarave të bashkisë, në kushtet kur transporti publik, apo transporti i nxënësve është shërbim i dobët.

Infrastruktura e dobët rrugore pengon edhe zhvillimin e bujqësisë sidomos në njësinë administrative Vergo por dhe zhvillimin kulturor dhe turistik të zonës. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore lidhëse ndërmjet qendrave të njësisë administrative dhe fshatrave, si dhe lidhjet rrugore mes fshatrave përbën një çështje prioritare.

3.4.3 Furnizimi me ujë të pijshëm

Një nga shërbimet bazë që ofron tashmë bashkia e re në kuadër të procesit të decentralizimit është dhe furnizimi me ujë të pijshëm për banorët e bashkisë. Një pjesë e mirë e fshatrave të bashkisë nuk arrin të furnizohet më ujë higjenikisht të pastër për 24 orë. Problem me furnizimin me ujë paraqesin edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit. Kryesisht furnizimi me ujë realizohet me stacion pompimi.

Problemi kryesor i bashkisë Delvinë, me 18,078 banorë, mbetet uji i pijshëm dhe punësimi. Zbatimi i një projekti që është gati tashmë do të zgjidhë problemin e ujit nga burimi i Vrizit për banorët e Delvinës që kanë 3 vjet me mungesë të ujit. Ndërtimi një rrjeti furnizimi me vetërrjedhje nga lumi i Kalasë, që buron nga Tatzati, fshat malor i bashkisë së re, zgjidhet problemi për të gjithë zonën. Zgjidhje përfundimtare është ndërtimi i ujësjellësit nga burimi i Kalasë, projekti i të cilit ka përfunduar. Ekipi i punës, administratën e sektorit të shërbimeve, do të mirë menaxhojnë përdorimin e ujit duke përmirësuar edhe rrjetin në rastet e amortizimit apo moslejimin e ndërhyrjeve në rrjet pa respektuar hartën e shpërndarjes dhe pa praninë e specialistit të bashkisë.

3.4.4 Infrastruktura bujqësore

Territori në të cilën shtrihet bashkia e Finiqit ka traditë të hershme angazhimin në bujqësi për vetë shtrirjen në fushën bujqësorë të Vurgut, të njohur për prodhimtarinë e lartë bujqësore. Aktualisht, kapaciteti bujqësor nuk është tërësisht i përdorur për shkak të një sërë problemesh. Infrastruktura e amortizuar bujqësore, kanalet vaditëse dhe kulluese jofunksional, rrjekti kryesor dhe sekondar i degraduar nuk mbështesin zhvillimin e këtij sektori në kapacitetin e plotë. Rikonstruksioni i kanalit vaditës Thoma Filipeu, duhet të përfundojë në gjithë gjatësinë e tij, me qëllim mbulimin e gjithë sipërfaqes së punueshme të tokës. Ky rikonstruksion përbën një investim kapital të kushtueshëm, por mban premtimin e rivitalizimit të kapacitetit bujqësor të zonës bujqësore të Vurgut.

4.4.5 Shërbimi i pastrimit

Aktualisht, shërbimi i pastrimit të rrugëve nuk është i shtrirë në të gjithë territorin e ri të bashkisë, kjo për shkak se kërkohet të rehabilitohen njëherë rrugët dhe më pas të bëhet mirëmbajtja e tyre. Nga qendra e Bashkisë dhe deri te njësitë administrative të saj nuk ka lidhje rrugore të cilat të mirëmbaheshin. Shërbimi i pastrimit shtrihet në një masë prej 67% të të gjitha rrugëve të bashkisë një shifër kjo shumë e ulët. Bashkia Delvinë dhe stafi i saj ka filluar punën për krijimin e planeve të reja rrugore duke bërë në këtë mënyrë një shpërndarje më të mirë të shërbimit të pastrimit për qytetarët e saj.

4.5 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore

Zhvillimi urban, konsumi jo i qëndrueshëm, mungesa e stimujve ekonomikë për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, ndotja historike e trashëguar, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë, praktikat jo të efektshme të menaxhimit në fushën e shkarkimeve në mjedis dhe mungesa e një sistemi të fortë për kontrollin e tyre, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë rënduar gjendjen e mjedisit duke përkeqësuar treguesit mjedisorë në bashkinë e Delvinës.

Lidhja e ngushtë midis mjedisit, si burim bazë dhe mirëqenie, ku veçanerisht varen kryesisht në burimet mjedisore të rinovueshme dhe në kapacitetin e vetë-rigjenerimit të mjedisit. Që këtu lind nevoja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe e zgjidhjes së problemeve mjedisore. Problemet mjedisore janë kryesisht të lidhura me ndikimin e aktivitetit njerëzor mbi burimet mjedisore. Këto marrin në përgjithësi formën e ndotjes, shterimit apo degradimit të ujërave, ajrit dhe tokës. Erozioni i tokës, kripëzimi dhe ndotja e ujërave, shkretëtirëzimi, shpyllëzimi llogariten si dëmet dhe problemet më të mëdha mjedisore që kanë ndikuar edhe ne qendrueshmërinë mjedisore të këtij territori.

4.6 Historia

Qyteti i Delvinës ngrihet rreze malit Sopot. Duke iu referuar gjuhes shqipe ky emer interesant mendohet ta kete prejardhjen nga bashkimi i dy fjaleve “dele” dhe “vijne” duke formuar fjalen “Delvine”. Eshte krijuar si humbje e ekzistences se nje mali i cili ka qene aty ku sot ngrihet krenarisht qyteti me te njejtin emer. Kete pamje e ben te tille edhe kalaja me emrin e lagjes “Xhermahalle” e cila ngrihet aty ku takohen dy malet. Ne te ruhen kujtime historiko-jetesore te transmetuara goja-gojes. Ne vitin 1990 popullsia e qytetit te Delvines eshte pergjysmuar nga 8000 ne 4000 banore. Ne te gjitha fshatrat ku jeton minoriteti grek kishat ortodokse jane rihapur dhe rindertuar. Ne shkollen nëntë-vjeçare ne kete periudhe numeroheshin rreth 250 nxenes, ku ne ditet e sotme mesojne vetem 100 prej tyre. Duke iu referuar literatures, studiuesi anglez Uiljam Martin Liku pas vizites qe i beri fshatrave dhe qytetit, jep kete informacion per Delvinen: “Te krishteret e Delvines prodhojne vere dhe tjerin ne tezgjah fije liri, prej te cilave bejne shajak, madje edhe kepuce. Ketu prodhohen gjithashtu edhe shpatat si dhe cdo pjese e pushkes, me perjashtim te atyre metalike”. Ne vitin 1670 Delvina eshte vizituar nga udhetare turq Elvija Celebiu, te cilet shkruajten per te ne librin e tyre te kujtimeve. “Perpara mesjetes Delvina ndodhej ne duart e Spanjolleve,



ku keta te fundit kishin konflikt ne Epir dhe me floten Greke. Ne kohen e udhetareve turq, Sanxhak Bej ishte Ajaz Pasha. Sanxhaku i Delvines perbehej nga 24 ziamete dhe 155 timare. Aty gjendej garnizoni turk dhe keshtjella drejtohej nga nje prej banoreve te saj. Ne qytet, gjendeshin 100 shtepi mbi te cilat vendasit varnin brrire cjapi. Arkitektura e tij eshte teper interesante. Shtepite, larg ose afer njera-tjetres kishin te gjitha nga nje kulle. Ajo qe i mungonte qytetit ishte nje mur rrethues. Delvina e sotme, shtrihet në këmbët e kështjellës, që është në kodrën me të njëjtin emër. Është vetëm 16 kilometra nga Saranda dhe në vitin1990 i është larguar gati një e treta e banorëve të saj në emigracion. Në vitin 2004, në qytet kishte vetëm rreth 4200 banorë. Qyteti i gjithë është në një shpat, ku rrinë bashkë një xhami dhe një kishë. Në Mesjetë, në kohët e dikurshme, ka qenë pjesë e Despotatit të Epirit. Një familje, e cila më vonë do kishte emrin Delvina, ka sunduar qytetin. Më 1354 mendohet se Mehmet Ali Pasha Delvina ka qenë zot i qytetit dhe kështjellës. Në shekulli e XVII-të, popullsia ishte konvertuar, ndërsa pjesa ortodokse kishte mbetur në fshatra, ku edhe sot ende gjenden shumë rrënoja kishash. Deri në luftën e Dytë Botërore, referuar literaturës zyrtare- flitet se ka pasur një komunitet të vogël hebrenjsh, nga Spanja- që kishin ardhur gjatë sundimin osman dhe kishin lidhje me hebrejtë e Janinës. Duket se e gjitha kjo vjetërsi u shkon shumë shtëpive me tiparet e vjetra arkitekturore. Në ditët tona, këto shtëpi, ku dominojnë ornamentimet e thjeshta të gurit, kulmet e qarta, portiqet disi të larta dhe oborret e brendshme janë gati të ngjitura me njëra-tjetrën. Ngjan si kohë e largët ajo, kur Çelebiu i përshkruan të 100 shtëpitë e Delvinës, që qëndronin aq larg sa edhe ishte distanca që kapte shigjeta. Ose, më saktë, që britmat kushtrimore të një shtëpie që e sulmonin kusarët, nuk mund të dëgjohen nga banorët e shtëpisë fqinjë. Pak e çuditshme për serenitetin që na predikon vetë Çelebiu. Ka tri shkolla fillore, tri teqe, një hamam, tre hane, ndër të cilët më i mirë është hani i Memi Pashës. Ka dhjetë kroje, ujë e ajër të mirë, ndërtesa të bukura. Lagjja e Lakes (sot "Lejla Malo"), e cila është në një gropë, është shumë e stolisur. Më poshtë është lagjja e Gjin Aleksit (sot Fshati Rusan), e veshur krejt me vreshta e kopshte. Në këtë lagje, në një vend të lartë, ndodhet ndërtesa e gjyqit.

Qytetarët e Delvinës kishin edhe besimin e tyre fetar. Këtë të fundit e dëshmojnë disa xhami, kisha, manastire dhe teqe në të cilat kryenin ritet e tyre fetare. Delvina gëzonte një zhvillim ekonomik dhe arsimor dhe këtë dëshmojnë tre medrese, 80 dyqane, dhe një qendër e madhe tregëtare që funksiononin në atë periudhë. Shumë interesant është informacioni që turqit Elvija, Celebiu japin në lidhje me gjuhën e pastër shqipe që përdorej në këtë kohë. Në shekullin e 17, Delvina ishte vend me kulturë lindore në të cilën bashkëjetonin harmonikisht dy fe: feja e krishtere ortodokse dhe ajo islamike. Ortodokset përgjithesisht jetonin në pjesët periferike të qytetit. Aty ndodheshin edhe shumë kisha të vjetra, në të cilat vazhdojnë të kryejnë ritet e tyre fetare. Kompleksi Gjin Aleksi Bektashi ne Rusan, Manastiri i Mesopotamit ne Delvine me emrin Shen Nikolas, kalaja e Xhermahalles po ne Delvine, jane vendet historike dhe arkeologjike me te lashta te qytetit. Te parë e Delvinës janë (Ispanja) spanjollët. Më vonë, venedikasit e shtinë në dorë me djallëzi. Kaloi në duart e sulltan Bajazitit, përsëri ra nën sundimin e të huajve dhe përsëri u mor nga sulltan Sulejmani, kur erdhi të mësyjë Korfuzin. Pushtimin e Delvinës ai ia ngarkoi Ajaz Pashës, shqiptar nga gjaku.

Delvina ishte sanxhak (prefekturë) më vete në vijaletin e Rumelisë. Sanxhaku i saj kishte një shpërblim të caktuar nga sulltani, që është 157,132 akçe (600 akçe = 1frang ar). Ajo kishte 24 ziamete dhe 155 timare. Ajo kishte allajbeg dhe Çeribash (komandant divizioni e kryeushtar). Në kohë lufte nxirrte sipas ligjit 2200 ushtarë. Kishte një gjyqtar kadi me 180 akçe shpërblim, kryemyftiun (Sheh Islamin), qehajanë e spahinjve, komandantin (serdarin) e jeniçerëve, komandantin (dizdarin) e kështjellës dhe ushtarët e tij, subashin e qytetit, tagrambledhësin (bazhdarin) e Bashkisë, qehajanë e qytetit, nëpunësin e financës dhe nëpunësin e haraçit.

3.7 Konkluzione

Bashkia e Delvinës tashmë ka një Plan Operacional të Zhvillimit Lokal i cili do të orientojë bashkinë dhe stafin e saj për nje zhvillim të qëndrueshëm të bashkisë. Realizimi i këtij plani do të monitorohet nga bashkia grupi i punës që është ngritur nga Kryetari dhe Këshilli Bashkiak si dhe nga përfaqësues të komunitetit. Zbatimi i këtij plani është i lidhur ngushtë më buxhetin e bashkisë e cila do të planfikojë investimet sipasi prioriteteve të përcaktuara në këtë plan. Gjithashtu do të aplikojë projektet e parashikuara në donatorë të ndryshëm që operojnë në Shqipëri, FZHR si dhe FSHZHsi dhe bashkëpunimi me kompani private për krijimin e Partneriteteve publiko-private.

Plani Stategjik i Zhvillimit Lokal është një domosdoshmëri ku do të ofrohet një pamje e qartë e bashkise Delvinë multi sektoriale që do ti japë zonës nje pikënisje për të koordinuar mundësitë dhe përpjekjet për një zhvillim të qëndrueshëm, një vend më të mirë për të jetuar, shfrytëzimin e të gjitha burimeve si natyrore dhe njerëzore drejt zhvillimit. Gjithashtu ky plan drejton gjithe punën e njësisë vendore dhe e bën më transparente ndaj qytetarëve.

Problemi kryesor i bashkisë së re Delvinë, me 18,078 banorë, mbetet uji i pijshëm dhe punësimi. Zbatimi i një projekti që është gati tashmë do të zgjidhë problemin e ujit nga burimi i Vrizit për banorët e Delvinës që kanë 3 vjet me mungesë të ujit. Ndërtimi një rrjeti furnizimi me vetërrjedhje nga lumi i Kalasë, që buron nga Tatzati, fshat malor i bashkisë së re, zgjidhet problemi për të gjithë zonën. Zgjidhje përfundimtare është ndërtimi i ujësjellësit nga burimi i Kalasë, projekti i të cilit ka përfunduar. Ekipi i punës, administratën e sektorit të shërbimeve, do të mirëmenaxhojnë përdorimin e ujit duke përmirësuar edhe rrjetin në rastet e amortizimit apo moslejimin e ndërhyrjeve në rrjet pa respektuar hartën e shpërndarjes dhe pa praninë e specialistit të bashkisë.

Ndërkohë për të zgjidhur papunësinë dhe ikjen e moshave të reja Bashkia e Delvinës duhet të krijojë partneritete publiko-private me biznese të ndryshme ose të ofrojë kushte lehtësuese për të krijuar vende të lira pune sidomos për moshën e re duke frenuar në këtë mënyrë migrimin e tyre në qytetet më të mëdha urbane.

Infrastruktura në qytetin e Delvinës është e mirë por problem ngelet infrastruktura në pothuajse gjithe fshatrat e saj. Rruga më e keqe është ajo që lidh Delvinën me fshatin Varfaj, për të cilën presim miratimin e projektit për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare.

Rehabilitimi i mjediseve shkollore dhe kopshteve të fëmijëve është një prioritet i bashkisë Delvinë. Paralel me rikonstruksionin e shkollave dhe kopshteve ekzistuese, bashkia do të mundësojë ndërtimin e këndeve të lojërave. Delvina nuk ka asnjë shkollë në standarde e duhura.

Nje domosdoshëri është rikonstruksioni i stadiumit dhe të fushës së sportit për aktivitetet

sportive që të rinjtë e kësaj zone do të organizojnë në të ardhmen.

Ndërtimi i landfill-it në fshatin Bajkaj, landfill në parametra që zgjidh problemin e përpunimit të mbetjeve, i jep fund përhapjes së plehrave nëpër territoret e bashkisë dhe fshatrave.

